



Data: 11/09/2020 Ref.: 1570/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
 - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MSc, 120 ECTS, maksimum 160 student për vit akademik
 - Politika Publike dhe Menaxhim, MA, 120 ECTS, maksimum 100 student për vit akademik
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, me specializim në: 1. Civil, 2. Penal, 3. Ndërkombëtar, maksimum 60 student për vit akademik
 - E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane Biznesore, LLM, 60 ECTS, maksimum 25 student për vit akademik
 - Infermieri BSc, 180 ECTS, maksimum 150 student për vit akademik
- II. Obligohet Kolegji UBT që deri me datë 31 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji UBT ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitivin I, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se këto programe i përmbush substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullosës nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji UBT
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë